



Ofrimi i granteve për qeveritë vendore, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Grupe Individësh

“Shkollat për Shëndetin” ka vijuar në krijimin e partneriteteve të qëndrueshme dhe efektive me qeveritë vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe agjentët kryesorë të ndryshimit.

Nëpërmjet partneriteteve efektive me pushtetin vendor dhe angazhimit të fortë për një bashkëpunim ndërsektorial, projekti ka realizuar me sukses ndërhyrje të ndryshme, të cilat rezultojnë në ndërtimin e kopshteve dhe këndeve të lojërave në shkollat 9-vjeçare në Elbasan, Belsh, Devoll, Poliçan, Peqin dhe Prrenjas. Këto grante janë realizuar me pjesëmarrje aktive nga pushteti vendor, shkolla, shoqëria civile dhe sektori privat.



Shkolla “Qamil Guranjaku”, Bashkia Elbasan



Shkolla “Dilaver Nezha”, Bashkia Prrenjas



Shkolla “Bishqem”, Bashkia Peqin



Shkolla “Refat Keli”, Bashkia Poliçan



Zgjerimi i aksesit në kujdesin dentar për fëmijët në zonat rurale në Shqipëri nëpërmjet njësive të lëvizshme

Projekti "Shkollat për Shëndetin" ka mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në blerjen e dy njësive të lëvizshme për ofrimin e shërbimit të kujdesit dentar (shëndetit oral) për fëmijët në Shqipëri, sidomos për ata që jetojnë në zona rurale. Më 15 shkurt 2023, u zhvillua event i prezantimit të njësive të lëvizshme të kujdesit dentar në Tiranë, me pjesëmarrjen e Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ambasadores Zvicerane.



Njësitë e lëvizshme të kujdesit dentar



[Lexo më shumë](#)

Zhvillimi i termave të referencës për specialistët e promovimit shëndetësor

Gjatë gjysmës së dytë, të vitit të dytë projektit, janë zhvilluar termat e referencës për specialistët e promovimit shëndetësor në nivele të ndryshme të sistemit të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë njësitë lokale të kujdesit shëndetësor, Institutin e Shëndetit Publik (ISHP) dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS). Është me rëndësi të theksohet se, në Shqipëri nuk ishin ndërtuar më parë termat e referencës për specialistët e promovimit të shëndetit, duke e bërë edhe më të domosdoshëm kontributin e projektit.



[Lexo më shumë](#)

Krijimi dhe fuqizimi i Rrjetit të Koordinatorëve të Shëndetit në shkolla

Projekti “Shkollat për Shëndetin” ka krijuar rrjetin e Koordinatorëve të Shëndetit në 60 shkollat e përcaktuara për ndërhyrje të thelluar gjatë periudhës dy-vjeçare të zbatimit të tij. Nëpërmjet këtij rrjeti është bërë i mundur shkëmbimi në mënyrë aktive i përvojave dhe praktikave më të mira në takime periodike, promovimi i rolit të Koordinatorit të Shëndetit në shkollë, promovimi i shëndetësisë përmes një sërë aktiviteteve të lidhura me edukimin shëndetësor dhe gjithashtu promovimi i stilet e jetesës dhe sjelljeve të shëndetshme. Vënia në zbatim dhe mirëfunksionimi i Koordinatorit të Shëndetit në shkollë, në shkollat nëntë-vjeçare në Shqipëri, është evidentuar si një model efektiv dhe i qëndrueshëm në edukimin shëndetësor.



Rrjeti i Koordinatorëve Shëndetësor

Gjithashtu, gjatë vitit të dytë të zbatimit, projekti “Shkolla për Shëndetin” ka mbështetur zhvillimin e manualit i cili udhëzon koordinatorët e shëndetit në nivel shkolle se si të kryejnë me efektivitet përgjegjësitë e tyre dhe të zbatojnë profilin e Koordinatorit të Shëndetit në shkollë, si një model i qëndrueshëm dhe efikas në edukimin e shëndetshëm në shkollat 9-vjeçare në Shqipëri.



PROFILI I KOORDINATORIT TË SHËNDETIT NË SHKOLLË

DRAFT-UDHËZUES PËR ZBATIMIN E
PROFILIT NË KONTEKSTIN E SHQIPËRISË

Tiranë, 2023

Draft-udhëzues për zbatimin e profilit të Koordinatorit të Shëndetit në shkollë



Lexo më shumë

Rritja e kapaciteteve të stafit të shkollës dhe specialistëve të promovimit të shëndetit në nivel vendor

Gjatë vitit të dytë të implementimit të projektit, janë kryer një sërë ndërhyrjesh gjithëpërfshirëse për ngritjen e kapaciteteve duke përfshirë ofrimin e trajnimeve onsite për mësuesit, specialistët e promocionit shëndetësor, përfaqësuesit e qeverisjes vendore dhe organizatat e shoqërisë civile, duke filluar fillimisht me trajnimin e trajnerëve, të ndjekur nga trajnime në kaskadë, veçanërisht me sesione trajnimi onsite brenda tre rajoneve të targetuara për ndërhyrje të thelluar (Durrës, Lezhë, Berat), si dhe trajnime online në qarqet e tjera në të gjithë Shqipërinë. Në total janë trajnuar rreth 3600 persona në të gjithë vendin. Si rezultat i sesioneve të trajnimit kaskadë, është evidentuar rritje e nivelit të njohurive, si më poshtë:

- 14.2% në nivelin e njohurive për sëmundjet JST;
- 19.0% në nivelin e njohurive për aktivitetin fizik;
- 15.1% në nivelin e njohurive për ushqimin e shëndetshëm;
- 14.4% në nivelin e njohurive për shëndetin mendor të fëmijëve;
- 7% në nivelin e njohurive për parandalimin e drogës dhe alkoolit.



Lexo më shumë

Fushata të suksesshme për promovimin e shëndetit dhe ndikimi i fëmijëve nga fushatat e "Karavanit të shëndetit"

Fushatat për promovimin e shëndetit kanë qenë të suksesshme në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e zakoneve të shëndetshme tek fëmijët, prindërit dhe mësuesit. Rreth 25,700 fëmijë kanë përfituar nga aktivitetet në terren të realizuara në kuadër të Projektit "Shkollat për Shëndetin", veçanërisht nëpërmjet fushatave të Karavanit të Shëndetit në Durrës, Lezhë dhe Berat.



Fushata e Karavanit të Shëndetit, Laç

Gjithashtu fëmijët kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm duke organizuar panaiere ushqimore, duke promovuar rëndësinë e mbajtjes së një diete të shëndetshme.



Panairi i Ushqimit, Berat, Nëntor 2022



Lexo më shumë

Edukimi i familjeve të shëndetshme nëpërmjet fushatave të prindërimit pozitiv dhe fuqizimi i prindërve për një mënyrë jetese të shëndetshme

Gjatë vitit të dytë të projektit, fushatat e prindërimit pozitiv kanë synuar prindërit dhe anëtarët e komunitetit në zonat urbane dhe rurale në Durrës, Lezhë dhe Berat. Rreth 1,000 prindër kanë marrë pjesë në një sërë ndërhyrjesh që promovojnë stile jetese të shëndetshme, të tilla si praktikatat e duhura të higjienës dhe mjedise të sigurta, gjatë sesioneve të prindërimit pozitiv.



[Lexo më shumë](#)

Kontributi për përfshirjen e komuniteteve në nevojë, zonave rurale, fëmijëve/prindërve/kujdestarëve me aftësi të kufizuara si dhe familjeve që i përkasin skemës së ndihmës ekonomike.

Të gjitha shkollat e përzgjedhura për ndërhyrje të thelluara në vitin e dytë të implementimit të projektit, konsistojnë në shkolla në zonat urbane, peri-urbane dhe rurale dhe përfshinin gjithashtu komunitete vulnerabël (minoritetet romë/egjiptiane ose nga zona të varfra të vendit) si në vijim:

- Fëmijë romë/egjiptianë: 843 (422 vajza dhe 421 djem);
- Fëmijë nga familjet e varfra: 2108 (986 vajza dhe 1122 djem);
- Fëmijët me nevoja të veçanta: 190 (101 vajza dhe djem 89 djem);
- Prindër/kujdestarë romë/egjiptianë: 230 (223 femra dhe 7 meshkuj);
- Prindërit/kujdestarët në varfëri: 524 (503 femra dhe 21 meshkuj).



[Lexo më shumë](#)

Aplikacionet Digjitale dhe Konkursset Digjitale të Shëndetit

Fëmijët e moshës 10-16 vjeç kanë përqafuar mjetet dixhitale dhe kanë zgjeruar njohuritë e tyre për praktikatat e një stili jetese të shëndetshme nëpërmjet përdorimit të aplikacioneve digjitale dhe Konkurseve Digjitale të Shëndetit. Konkursset me një impakt të gjerë tek vetë fëmijët, janë zhvilluar në Durrës, Korçë, Lezhë, Tiranë, Elbasan dhe Berat, duke patur dy objektiva kryesore.



Konkursi i Shëndetit Digjital, Shkolla “Marie Kaçulini”, Durrës



Lexo më shumë

Forcimi i kapaciteteve të shkollës për promocionin shëndetësor tek fëmijët

Implementimi i ndërhyrjeve të thelluara në shkollat e përzgjedhura ka sjellë progres të dukshëm në aktivitetet jashtëshkollore dhe promovimin e temave që lidhen me shëndetin. Në mënyrë të dukshme, krijimi i shtatë klubeve të shëndetit, pesë prej tyre në zonat rurale, ka ofruar mundësinë e diskutimit për tema të ndryshme shëndetësore, duke rritur edhe cilësinë e mësimdhënies. Për më tepër, tetë qendra burimore, dy prej të cilave në zonat rurale, janë krijuar ose rinovuar brenda shkollave për të shërbyer si burime të vlefshme informacioni si për nxënësit ashtu edhe për prindërit, me fokus të veçantë në plotësimin e nevojave të fëmijëve me kërkesa të veçanta.



Qendra Burimore Shkolla Uznovë, Berat



Lexo më shumë